



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.1703/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike të paditësit: Champion Products Europe Limited, Suite 8, 212 Plaza, Blanchardstoën Cororate Park 2, Dublin 15, nga Irlanda, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Av. XH.R.R., me adresë në Rr. "Ndue Përlleshi" në Prishtinë, kundër të paditurit: "PROEX" Sh.p.k, me numër unik 810806862 Rr. "Fehmi Lladrovci" nr.32 Prishtinë, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së seancës gjyqësore të datës 12.02.2024, në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse, me datën 20.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit "Champion Products Europe Limited" nga Irlanda dhe VËRTETOHET se i padituri PROEX" Sh.p.k, me numër unik 810806862 Rr. "Fehmi Lladrovci" nr.32 Prishtinë, ka shkelur markën tregtare të paditësit me numër të regjistrimit 051-1,052-2 të datës 2009 si dhe I NDALOHET të paditurës që në të ardhmen të importoj apo në çfarëdo forme të tregtoj mallra që shkelin markën "Champion Products Europe Limited" nga Irlanda.
- II. OBLIGOHET i padituri që të bëjë shkatërrimin e 1664 parë bluza që shkelin markën tregtare "Champion Products Europe Limited" nga Irlanda, si dhe DETYROHET e paditura që nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e mallit ose t'i paguajë shpenzimet e shkatërrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

- III. DETYROHET i padituri që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 470.00€, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e Palës Paditëse.-

I autorizuari i paditësit kishte deklaruar se mbetemi në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe në deklaratimet nga seanca e datës 12.02.2024, për shkakun se i padituri sipas listës së distribuimit 71-2021 ka tentuar të fusë produkte të cilat janë konstatuar nga paditësin se janë produkte fallco me shenjën e mbrojtur të paditësit. Paditësi ka të mbrojtura disa shenja të Markës Tregtare (MT) siç janë cekur edhe në padi dhe gëzojnë mbrojtjen ligjore për mos përdorimin e dikujt tjetër pa autorizim. Nga fotografitë të cilat i ka bërë Dogana e Kosovës dhe të cilat i ka verifikuar edhe paditësi, ka lëshuar një vërtetim apo një deklaratë me të cilën ka konstatuar se produktet e ndaluara sipas rastit 71-2021 janë produkte të falsifikuara apo nuk janë produkte të bartësit të së drejtës së Markës Tregtare të paditësit. Andaj, propozoj Gjykatës që produktet e tilla të mbahen në ndalim dhe të asgjësohen me procedurë të rregullt të asgjësimit. Shpenzimet e procedurës i kërkoj edhe atë: 200.00euro për përpilimin e padisë dhe nga 135.00euro për dy seanca, sipas tarifës së OAK-së.

I autorizuari i palës paditëse në përgjigje në padi kishte deklaruar se marka në fjalën KS/M/2014/001042 është regjistruar si e tillë duke u bazuar në përshkrimin ndërkombëtarë të saj të identifikimit me numër serik 862864669 si marka tregtare Champion e cila përben një formë kaligrafike të stilizuar të termit Champion dhe si e tillë në mënyrë asociative emblema apo logoja paraqet një formë të stilizuar të shkronjës “C”.

Sipas paditësit produkti kontestues asnjëherë nuk mund të paraqet konfuzion apo ngjashmëri të pa diferencushme në mes të saj dhe markës Champion sepse nuk na paraqitet në asnjë formë stilizuese të termit Champion apo të shkronjës stilizuese C. Në rasti tonë në mes emblemës dhe në fjalë nuk mund të tejkaloi aspektin teknik dhe nuk mund të vërehet me syrin e lirë pa ndonjë konkludim apo analizë të thell të strukturës dizajnuese.

Prandaj bazuar nga të lartcekurat i propozojmë Gjykatës që ta refuzoj në tërësi kërkesë padinë e paditësi si të pa bazuar, të obligohet Dogana e Kosovës të liroj mallin në treg dhe të obligohet pala paditëse të paguaj shpenzimet e procedurës.

Administrimi i Provave.-

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata i administroi provat materiale secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku konform nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe atë provat si në vijim:

- Vendimi me numër 051-1/2014, i dt.23.07.2014;
- Vendimi me numër 052-1/2014, i dt.22.07.2014;
- Lista e distribuimit e lëshuar nga Dogana e Kosovës e datës 02.04.2021;
- Pesë fotografi-foto dokumentacione;
- Deklarata doganore me numër 71/2021 e datës 02.04.2021.

Gjykata i administroi secilën provë veç e veç dhe nga administrimi i provave veç e veç, vërtetoi këtë gjendje faktike:

-Nga Vendimet me 051-1/2014, i dt.23.07.2014 dhe Vendimi me numër 052-1/2014, i dt.22.07.2014, gjykata vërtetoi se bartësi i markës tregtare Champion Products Europe Limited, Suite 8, 212 Plaza, Blanchardstoën Cororate Park 2, Dublin 15, nga Irlanda, për produktet të klasave 25,28 është paditësi, vendime të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencia për Pronësi Industriale. Pra nga këta vendime konstatohen se marka tregtare është e regjistruar në organet kompetente të Republikës së Kosovës dhe ka vazhdimësi deri me datën

01/03/2024, pra gjykata vlerësoi se kjo provë vërteton validitetin e Markës Tregtare të mirënjohur, prandaj këtyre provave të administruara dhe të elaboruara gjykata ia fali besimin.

-Nga lista e distribuimit lëshuar nga Dogana e Kosovës e datës 02.04.2021, konfirmohet se mallrat e konfiskuara përbëjnë shkelje të markës tregtare dhe konstatoihet se Dogana e Kosovës si Institucion përgjegjës ofron pëlqimin për shkatërrimin e tyre, prandaj nga kjo provë vlerësohet nga gjykata si provë kredibile ngase kjo listë e mallrave është lëshuar nga Institucioni i cili ka përgjegjësi të vërtetohet parregullsitë e mallrave që nuk kanë të drejtën e importit pa lejen apo pa pëlqimin e bartësit të drejtës së markës tregtare. Po ashtu në këtë listë specifikohen se mallrat e ndalura në sasi prej 1664 copë bluza me krahë të shkurtër.

-Nga Deklarata me numër 71/2021 e datës 02.04.2021, të dërguar nga paditësi, gjykata vlerësoj se nga kjo deklaratë vërtetohet se mallrat e ndaluara nga Dogana e Kosovës nuk janë produkte të paditësit. Ndërsa pesë fotografi-foto dokumentacione gjykata i vlerësoi se prova që nuk kishin ndonjë relevance, prandaj nuk u elaboruan, ngase të njëjtat nuk do të kishin ndonjë ndikim në marrjen e vendimit ndryshe.

Vendimi i Gjykatës.-

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse nga Vendimi me numër 051-1/2014, i dt.23.07.2014 dhe Vendimi me numër 052-1/2014, i dt.22.07.2014 është e pa kontestueshme se bartësi i markës tregtare është Champion Products Europe Limited, Suite 8, 212 Plaza, Blanchardstoën Cororate Park 2, Dublin 15, nga Irlanda, për produktet të klasave 25,28, kjo për faktin se këtë qëndrim gjykata e mbështet në vendimet e lëshuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencia për Pronësi Industriale. Po ashtu gjykata konstaton se shenja që është përdorur në produktet e të paditurit janë identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijojë bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit.

Nga ky konstatim i gjendjes faktike gjykata duke iu referuar nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT) i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Në këtë rast bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT-së, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta të: ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion (Nenet 8 – 13 i LMT); të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës (Neni 14 i LMT), si dhe të disponojë me markën tregtare të tij (Nenet 15 – 22 i LMT).

Mbajtësi i një marke tregtare sipas Nenet 8 të LMT-së, ka të drejtë të ndalojë: vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e saj për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij, importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare dhe përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare. Sipas Nenet 8 të LMT-së, shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëri prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se i padituri ka importuar mallrat kontestuese pa autorizimin e paditësit si bartës i të drejtave nga marka tregtare e regjistruar “Champion Products Europe Limited, Suite 8, 212 Plaza, Blanchardstoën Cororate Park 2, Dublin 15, nga Irlanda. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, fakti se mallrat janë origjinale

ose jo, nuk përbën fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare. Bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të markës tregtare.

Megjithatë, sikurse edhe shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, Ligji për Markat Tregtare i Kosovës aplikon parimin e ezaurimit nacional derisa Republika e Kosovës të anëtarësohet në Bashkimin Evropian (neni 12, paragrafi 1 i LMT të aplikueshëm në rastin konkret). Pra, sipas kësaj të drejtat e bartësit të markës së regjistruar për të kontrolluar qarkullimin e mallrave apo shërbimeve do të pushojë vetëm kur këto mallra apo shërbime janë futur në tregun e Kosovës nga pronari apo me pëlqimin e tij. Për pasojë, në rast të importit paralel apo vendosjes së produkteve të caktuara (autentike) në tregun e Kosovës, pa lejen e bartësit, i njëjti mund të kërkojë nga gjykata të ndalojë një veprim të tillë meqë ky veprim paraqet shkelje të markës tregtare të mbrojtur.

Neni 12 i LMT-së, përcakton qartë se: *“humbja e të drejtës për ndalimin e përdorimit të markës për produkte dhe shërbime fillon me futjen e markës në tregun e Republikës së Kosovës nga ana e vet pronarit ose pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, në ndonjërin nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian apo shteteve që janë palë në Marrëveshjen që krijon Zonën Ekonomike Evropiane, me atë markë tregtare”,* çka nënkupton se shtetja e së drejtës sipas shitjes së parë bëhet vetëm në rastet kur bartësi i të drejtës së markës tregtare e shet vet atë produkt apo përmes të autorizuarit të tij, në territorin e Republikës së Kosovës, por kjo e drejtë nuk konsumohet nëse produkti është shitur jashtë Republikës së Kosovës.

Duke u nisur nga të lartcekurat, gjykata ka gjetur se i padituri me importimin e mallrave kontestuese dhe vënien e tyre në treg, pa autorizimin e bartësit të markës tregtare të regjistruar, e ka shkelur markën tregtare të paditësit.

Vendimin për shkatërrimin e produkteve dhe atë 1664 bluzave me krahë të shkurtër, shpenzimet e të paditurit, gjykata e mori konform dispozitave të nenit 28 të Ligjit Nr. 05/L – 040 për

Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-026 për Markat Tregtare dhe nenit 99 të Ligjit Nr.04/L-026 për Markat Tregtare.

Shpenzimet e procedurës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi me rritje 100 % për faktin se ky kontest është me element të huaj, duke i specifikuar dhe atë: 50 € në emër të taksës për padi, 200 € (200) për përpilimin e padisë, dhe nga 135.20 € për dy seanca të mbajtura ($135.20 \times 2 = 270.00$ €), në shumën e përgjithshme prej 470.00€

Nga arsyet e cekura më lartë dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1703/22, datë 20.02.2024

Gjyqtari,
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.